



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1687/19 Prot.

Tiranë, më 07.03. 2025

U D H Ë Z I M

Nr. 13, Datë 07.03. 2025

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 8.7.2019 “PËR PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 101, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 16, datë 8.7.2019 “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Pikat 5, 8 dhe 10 të Kreut I, ndryshojnë si më poshtë:

“5. Aplikimi për pajisjen me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave bëhet nga IAL-të në platformën e-Albania dhe aplikimi shqyrtohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (në vijim “QSHA”).

Krahas formularit të aplikimit, që duhet të përmbajë emërtimin e njësisë kryesore, emërtimin dhe llojin e programit të studimit, forma e studimit (me kohë të plotë ose me kohë të zgjatur), IAL-ja ngarkon mandat - pagesën për QSHA, si dhe autorizimin e rektorit për punonjësin e IAL-së për tërheqjen e tyre.

Qendra e Shërbimeve Arsimore siguron me ndërveprim nga institucioni përgjegjës:

a) aktin e hapjes së IAL-së;

b) aktin e akreditimit të parë ose të akreditimit periodik të IAL-së;

c) aktin e hapjes së programit të studimit;
ç) aktin e akreditimit të parë ose akreditimit periodik të programit të studimit (kur është kryer nga Bordi i Akreditimit përpara lëshimit të diplomave).”

...

8. Pajisja e IAL-ve me regjistra bëhet përpara fillimit të vitit akademik, por jo më vonë se data 31 tetor e çdo viti akademik”.

...

10. Në rast ndryshimi/riorganizimi të IAL-së, njësisë kryesore apo të programit të studimit, IAL-ja bën aplikim të ri për regjistër themeltar, regjistër të arritjeve akademike dhe regjistër të lëshimit të diplomave dhe certifikatave.”

b) Pika 1 e Kreut V, shfuqizohet.

c) Pas pikës 3, të kreut V, shtohet pika me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre dhe të dhënat pasqyrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL).”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

